

VENDIM
Nr.480, datë 1.8.2007

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.216, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PUBLIK, PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA, PËR RESTAURIMIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me porpozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, të kreut I, pas togfjalëshit “Instituti i Kulturës Popullore...” shtohen fjalët “...apo Ministria e Turizmit , Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

2. Paragrafi i katërt, i pikës 1, të kreut II, ndryshohet si më poshtë, vijon:

“Juristi i komisionit ka për detyrë zbatimin e ligjit gjatë të gjithë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, mbajtjen e procesverbaleve të punës së komisionit, administrimin e dosjeve përkatëse, si dhe përgatit çdo komunikim me shkrim, për procedurën e zhvilluar deri në lidhjen e kontratës.

Njësia e vlerësimit ka për detyrë vlerësimin e ofertave ekonomike, si dhe shpalljen e ofertës më të mirë ekonomike.

Procesverbalet e punës nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Përgjegjës për zbatimin e kontratës është institucioni, i cili është i autorizuar për lidhjen e kontratës.”.

3. Në fund të pikës 2, të kreut III, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ankesat për procedurën e zhvilluar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i drejtohen Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Vendimi i tij është përfundimtar.”.

4. Në pikën 1, të kreut IV, hiqen fjalët:

“...dhe që ka zhvilluar konkurrimin...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha